



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr. 60/01-11118/22
Kaçanik, 26.04.2022

PROCESVERBAL

Nga mbledhja **IV (katërt)** e Rregullt e Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 26 Prill 2022(e martë). Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të administratës Komunale, në sallën e Kuvendit, me fillim pune në ora 10:00.

Pjesëmarrës të këtij takimi nga Komiteti për Komunitete ishin: Lejla Muhaxheri-Çaka-PDK, Arta Avdiu-LVV, Betim Shala-LDK, Ekrem Livoreka-AAK. Ndërsa Arben Thaqi-OJQ ka munguar në mbledhje.

Mbledhjen e udhëhoqi, kryesuesi i Komitetit për Komunitete, Ekrem Livoreka.

Procesmbajtëse ,Arbnora Kuka, Asistente e Kryesuesit të Kuvendit.

z.Ekrem Livoreka, Fillimisht përshëndes të pranishmit, konstatoj kuorumin dhe hapi mbledhjen e IV-të (katërt) të rregullt të Komitetit për Komunitete për vitin 2022, data 26 Prill, me këtë :

REND PUNE

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e fundit e Komitetit për Komunitete;
2. Gjendja e Arsimit në komunën e Kaçanikut; dhe
3. Të ndryshme.

Nëse ka diçka rreth rendit të punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendi i punës u shtrua në votim dhe u votua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së Komiteti për Komunitete

APROVOJ

Rendin e punës, në përbërje prej 3 pikave

1.Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e fundit e Komitetit për Komunitete

Kryesues i Komitetit, Ekrem Livoreka, A keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo atëherë, a jeni për miratimin e këtij procesverbalit ?

Procesverbalit i mbledhjes se III-të (tretë) të Komitetit për Komunitete i vitit 2022, u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se Komitetit për Komunitete e,

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes se III-të të Komitetit për Komunitete të vitit 2022, të datës 21.03.2022 / Lënda : 01Nr.60/01-7521/22.

2. Gjendja e Arsimit në komunën e Kaçanikut

Kryesues i komitetit ,Ekrem Livoreka, Në takim e kemi ftuar edhe drejtorin e arsimit, mirëpo nuk e dimë arsyen e mospjesmarrjes, ndoshta për shkak të angazhimeve. Drejtoria e arsimit , nxënësve me gjendje të rëndë ekonomike, i paguan udhëtimin për në shkollë. Është një hap shumë pozitiv. Problem kemi me nxënësit në shkolla. Kërkojmë nga drejtoria e arsimit që në bashkëpunim me policinë të dalin kontroll në shkolla. Shqetësuese janë dukurit negative që janë në shkolla, siç është përdorimi i narkotikëve nga nxënësit, armët e ftofta etj. Këto janë ankesat kryesore. Dhe falenderoj për iniciativën e pagesës së nxënësve me gjendje të rëndë ekonomike. A keni diçka për diskutim?

Znj. Arta Avdiu, Të flasim për arsimin ka shumë , por në mungesë të drejtorit dhe nuk kemi si ti drejtohem. Ka shumë mungesa të nxënësve në shkolla. Kishte dallime në notën mesatare në SHFMU “Emin Duraku” me SHMP”Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka”.


Kryesues i komitetit ,Ekrem Livoreka, Nëse nuk keni diçka tjetër rreth kësaj pike , kalojmë në pikën tjetër të rendit të punës.

4. Të ndryshme

Kryesues i komitetit ,Ekrem Livoreka, Si komitet duhet të organizojmë vizita dhe takime në bazë të planit të punës .

Mbledhja e katërt e Komitetit për Komunitete , mbajtur më datë 26.04.2022, i përfundoi punimet në ora 10:50.

Procesmbajtës
Arbnora Kuka



Kryesues i Komitetit për Komunitete
Ekrem Livoreka

